



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT**

Prishtinë, më 8 shtator 2011
Nr. ref.: 136/11

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin Nr. KI-100/10

Parashtruesi

Eduard Thaqi (gjithashtu i njohur si Sokol Thaqi)

Vlerësim i kushtetutshmërisë së Vendimit të Policisë së Kosovës, Nr. 398-SHPK-2002, të 22 tetorit 2002

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

E përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar
Kadri Kryeziu, Zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Ivan Čukalović, gjyqtar
Gjyljeta Mushkolaj, gjyqtare dhe
Iliriana Islami, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtrues është z. Eduard Thaqi (i njohur më parë si Sokol Thaqi), me vendbanim në Kishnicë.

Pala kundërshtare

2. Palë kundërshtare është Policia e Kosovës.

Objekti i çështjes

3. Parashtruesi e konteston vendimin e Policisë së Kosovës, 398-SHPK-2002, të 22 tetorit 2002, me anë të të cilit ishte larguar nga puna.
4. Për më tepër, parashtruesi pohon për shkelje të nenit 49 [E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesioneve] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Kushtetuta).
5. Përveç kësaj, parashtruesi kërkoi që të mos i zbulohet identiteti në vendimin e Gjykatës Kushtetuese.

Baza juridike

6. Neni 113.7 i Kushtetutës, neni 20 i Ligjit Nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, i 15 janarit 2009 (në tekstin e mëtejshëm: Ligji), dhe rregulli 36 3 (h) i Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

7. Parashtruesi e parashtroi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Gjykata) më 8 tetor 2010.
8. Më 17 nëntor 2010, kërkesa iu komunikua Policisë së Kosovës, e cila u përgjigj më 6 dhjetor 2010.
9. Më 7 dhjetor 2010, Kryetari e caktoi gjyqtarin Almiro Rodrigues Gjyqtar raportues. Po të njëjtën datë, Kryetari e caktoi Kolegjin shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët Ivan Čukalović (kryesues), Kadri Kryeziu dhe Enver Hasani.
10. Më 6 janar 2011, Gjykata kërkoi dokumente shtesë, të cilat parashtruesi i dorëzoi më 18 janar 2011.
11. Më 25 mars 2011, kërkesa iu komunikua Ministrisë së Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë (në tekstin e mëtejshëm: MASHT), e cila u përgjigj më 28 mars 2011.
12. Më 20 maj 2011, dhe 23 shtator 2011, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues Almiro Rodrigues dhe i rekomandoi Gjykatës për papranueshmëri.

Përmbledhja e fakteve

13. Parashtruesi iu bashkua Policisë së Kosovës më 19 shkurt 2000, ku shërbeu në pozita të ndryshme, një prej tyre ishte në cilësinë e hetuesit në kuadër të Njësise për Persona të Zhdukur.
14. Më 22 tetor 2002, parashtruesi u përjashtua nga puna për shkak se, ndër të tjera, dosja e tij përmbante informata jo të sakta. Policia e Kosovës tha me sa vijon:

"Sokol Thaqi, ju ishit i pasinqertë dhe aplikacioni juaj për punësim në Shërbimin Policor të Kosovës përmban informata/dokumente jo të sakta. Ju keni dështuar t'i plotësoni kushtet minimale për punësim në SHPK."

"Bazuar në dëshmitë e lartshënuara kundër juve, Sokol Thaqi, KPS # 0566, largoheni nga Shërbimi Policor i Kosovës për shkak të shkeljes së Parimeve dhe Procedurave të SHPK-së."

15. Më 3 dhjetor 2002, parashtruesi pati një intervistë me Bordin për Ankesa të Policisë së Kosovës, me ç'rast atij, gjoja, i ishte premtuar se do të rikthehej në punë si zyrtar i Policisë së Kosovës nëse e ofron diplomën e shkollës së mesme. Pas kësaj, parashtruesi e regjistroi shkollën e mesme në Obiliq dhe mori diplomën e shkollës së mesme, të cilën e dorëzoi në Policinë e Kosovës.
16. Më 28 gusht 2004, pas marrjes së diplomës së shkollës së mesme, parashtruesi kërkoi nga Policia e Kosovës që ta ri-punësonte.
17. Policia e Kosovës shkoi në MASHT për ta verifikuar diplomën e shkollës së mesme të dorëzuar nga parashtruesi.
18. Parashtruesi thekson që MASHT-i e informoi Policinë e Kosovës se diploma e parashtruesit ishte kontestuese.
19. Prej 25 nëntorit 2004 e këtej, parashtruesi i inicioi disa procedura administrative dhe gjyqësore për ta sqaruar vlefshmërinë e diplomës.
20. Më në fund, më 2 maj 2006, MASHT-i i pranoi dëftesat dhe diplomat e të gjithë nxënësve që i kishin kaluar provimet përkatëse të vitit përkatës shkollor, duke përfshirë parashtruesin.

Pretendimet e parashtruesit

21. Parashtruesi pohon që edhe pse e kishte mbaruar shkollën dhe marrë diplomën e vlefshme shkollërore, ai ende nuk ishte ri-punësuar si zyrtar i Policisë së Kosovës, përkundër faktit që atij i ishte premtuar se do të ri-punësohej sapo t'i paraqiste kualifikimet përkatëse.
22. Parashtruesi, gjithashtu pohon që kishte pasur intervistë të suksesshme me Policinë e Kosovës dhe se vetëm priste t'ia rifillonte punës si zyrtar i Policisë së Kosovës.
23. Për më tepër, parashtruesi pohon që ishte inkurajuar nga Policia e Kosovës të aplikonte për pozita të reja në dispozicion në polici, gjë që, sipas parashtruesit, është e pamundur sepse Policia e Kosovës nuk rekruton më kadetë të rinj.
24. Sa i përket kërkesës së tij për moszbulim të identitetit, parashtruesi ishte në dijeni se vendimi do të mund të merrej vetëm në bazë të argumenteve të paraqitura nga ai. Ai nuk kishte dhënë asnjë arsye për ta mbështetur atë kërkesë.
25. Nga dokumentet e dorëzuara duket që parashtruesi kërkon nga Gjykata që:
 - a) ta kthejë në vend të punës si zyrtar i Policisë së Kosovës; dhe
 - b) t'ia caktojë kompensimin e drejtë për dëmet e shkaktuara gjatë periudhës që kishte mbetur pa punë.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

26. Për të gjykuar për kërkesën e parashtruesit, Gjykata së pari duhet të shqyrtojë nëse parashtruesi i ka përmbushur kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara në Kushtetutë, Ligj dhe Rregullore të punës.
27. Sa i përket kërkesës së parashtruesit, Gjykata i referohet rregullit 36 (3) (h), i cili thotë:
- “Po ashtu një kërkesë mund të konsiderohet si e papranueshme edhe në rastet vijuese kur:*
- (h) kërkesa nuk është ratione temporis në pajtim me Kushtetutën”.*
28. Për ta përcaktuar juridiksionin kohor të Gjykatës është me rëndësi të identifikohet, në secilin rast specifik, koha e saktë e shkeljes së supozuar. Me këtë rast, Gjykata duhet të marrë parasysh faktet për të cilat parashtruesi ankohet dhe sferën e të drejtës kushtetuese që supozohet të jetë shkelur (shih, *mutatis mutandis*, Aktgjykimi i Dhomës së Madhe të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut në Rastin Blečić kundër Kroacisë, Kërkesa Nr. 59532/0, e 8 marsit 2006, paragrafi 82).
29. Gjykata vëren që parashtruesi ankohet se i është shkelur e drejta e punës, e garantuar me Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Në këtë drejtim, parashtruesi e konteston Vendimin e Policisë së Kosovës, Nr. 398-SHPK-2002, të 22 tetorit 2002.
30. Kjo do të thotë që shkelja e supozuar e të drejtës së parashtruesit, e garantuar me Kushtetutë, ndodhi para 15 qershorit 2008, që është data e hyrjes në fuqi e Kushtetutës, dhe prej të cilës datë Gjykata ka juridiksion kohor.
31. Prandaj, rezulton që kërkesa e parashtruesit nuk është “*ratione temporis*” në pajtim me dispozitat e Kushtetutës.

PËR KËTO ARSYE


Në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, dhe nenin 36 (3) (h) të Rregullores së punës, më 20 maj 2011, dhe 23 shtator 2011, Gjykata Kushtetuese njëzëri

VENDOS

- I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;
- II. TA REFUZOJË si të pabazë kërkesën për moszbulim të identitetit të tij;
- III. Ky Vendim do t’u komunikohet palëve dhe do të publikohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari Raportues

Almiro Rodrigues



Kryetari i Gjykatës Kushtetuese

Prof. Dr. Enver Hasani